



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština – Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni vjeshtor

Komisioni për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor
Mbledhja nr. 51
Prishtinë, më 14.11.2016, ora 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S1

PROCESVERBAL

Në mbledhje morën pjesë: Duda Balje, Adem Salihaj, Emilija Rexhepi, Shaip Muja, Time Kadrijaj dhe Murat Hoxha.

Munguan: Sergjan Popoviq, Haxhi Shala dhe Salih Salihu.

Stafi mbështetës i Komisionit: Bajram Badivuku.

Mbledhjen e kryesoi, **Duda Balje**, kryetare e Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.11.2016;
3. Shqyrtimi i raportit mjedisor për vitin 2016 ;
4. Të ndryshme.

Kryesuesja **Duda Balje**, konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen sipas rendit të përcaktuar të ditës .

1. Miratimi i rendit të ditës;

Rendi i ditës për këtë mbledhje u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së datës 10.11.2016;

Procesverbali i mbledhjes së mbajtur më 10.11.2016, u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i raportit mjedisor për vitin 2016;

Duda Balje, kryetare, përshëndeti ministrin e MMPH-së me bashkëpunëtorë **Mendim Rugova,** zëvendësministër dhe **Illir Morina,** kryeshef i Agjencisë për Mjedis, nga të cilët kërkoi një raport për gjendjen e mjedisit në Kosovë për këtë vit, duke pasur parasysh që vitin e kaluar ka pasur vërejtje nga deputetët, që ky raport të paraqitet nga MMPH-ja më realisht.

Ushtruesi i detyrës së ministrit, **Ferat Shala** falënderoi për këtë takim dhe theksoi se mbrojtja e mjedisit e ka koston e vet, të cilën e vështirësojnë borxhet ndaj institucioneve tjera, që do të thotë se përveç që janë paraparë 42 milionë, borxhet janë 150 milionë, por megjithëkëtë MMPH-ja ka solucione të tjera si të kontribuojë në zgjidhjen e problemeve mjedisore, siç janë donacionet etj.

Illir Morina, fillimisht potencoi ndotësit e mëdhenj të cilët vazhdimisht raportojnë për shkallën e ndotjes me të cilat problem ka edhe tërë Evropa, transporti rrugor i cili përcjelljen e ndotjes e ka 40 % dhe nuk ka mjete për monitorim, ndotja nga ujërat të cilat përcjelljen me projekte nga SIDA, GIZ-i etj, mbeturinat industriale dhe të tjerat, të cilat mund të mbikëqyren vetëm përmes mjeteve të mëdha financiare dhe së fundi inspektoratet mjedisore dhe mundësinë e tyre të mbikëqyrjes.

Agjencia mjedisore e Kosovës tani ka një praktikë evropiane EUNET, ku raportohet 5 herë në vit, mirëpo, mjedisi ka një kosto të lartë, përfundoi Morina.

Kryetarja pasi theksoi se ndotja e ajrit, më së tepërmi vështirëson jetën e njeriut në Kosovë, pyeti se sa bashkëpunon MMPH-ja me MSH-në dhe qytetarin të cilit duhet ti tregojë se në çfarë ajri jeton.

Adem Salihaj vlerësoi se raporti i sivjetmë dallon nga ai i vitit të kaluar, i cili është refuzuar nga Kuvendi, ngase çdo gjë që është shkruar aty, ishte paraqitur gjendja ideale pa asnjë problem mjedisor dhe bëri thirrje që ky raport, i cili përshkruan gjendjen më reale, të shërbejë pozitivisht në mënjanimin e ndotjes së mjedisit, fillimisht të ajrit dhe kështu me radhë. Salihaj potencoi tejkalimet te ajri prej 50 deri 800 miligramë, pra 1600 më tepër sesa lejohet dhe i ceku disa komuna ku vërehet ndotja më e madhe dhe kërkoi nga Agjencia e Mjedisit, monitorim të vazhdueshëm, sidomos rajonet ku janë Kosova B, Sharrceci, Ferronikeli, transporti rrugor etj., potencoi se disa komuna si Ferizaj, ku nuk ka stacion për matjen e ndotjes së ajrit por edhe të lumenjve që paraqesin brengosje gjithnjë e më shumë ngase fabrikat hedhin mbetjet në lumenj.

Sa i përket mbeturinave, ai potencoi se nuk ka të bëjë ky problem më tepër me kulturën sesa me ligjin, ngase ligji duhet të jetë ai që do të zbatohet dhe do ti frikësojë qytetarët sa i përket hedhjes së mbeturinave (siç është p.sh. Zvicra dhe shumë shtete që kanë këtë çështje me masa tepër rigorozë ligjore) dhe pastrimit të tyre sidomos edhe duke

bashkëpunuar me MB-në sa i përket një lloji të drurit (Taullonia) që mund të jetë më vonë e kobshme për banorët përreth.

Time Kadrijaj potencoi gjendjen e rëndë mjedisore rreth komunës Obiliq, Hade dhe apeloj për mekanizma monitorues, duke mos anashkaluar Institutin për Mbrojtjen e Natyrës, vërshimet dhe shkakun e shkaktimit të tyre dhe rrjedhjen e tyre, si trajtohen mbeturinat në Qendrën Klinike Universitare.

Shaip Muja mbështeti kërkesën për hartimin e raportit mjedisor dhe u fokusua në riciklimin e mbeturinave, gjë e cila bëhet në Shqipëri, duke theksuar se preventiva gjithmonë ka qenë masë më e mirë sesa sanimi.

Në diskutimin e serishëm, ministri Ferat Shala theksoi se përkundër vështirësive financiare të cekura në fillim, ministria me gjithë probleme të trashëguara ka përparime, megjithëse MMPH-ja është detyruar të stagnojë në dhënien e licencave-lejeve edhe pse është e obliguar që ti lëshojë ato, ngase fillimisht duhet të hartohen strategjitë. Kosova është e mbuluar 11% me parqe nacionale por nuk ka legjislacion që i mbron ato, andaj kërkoj bashkëpunim në hartimin e legjislacionit dhe rishikim të atyre ligjeve ekzistuese për ti ndryshuar me pak nene, por fillimisht duhet iniciativë për plotësime apo ndryshime. Rreth ndotjes së ajrit, tha se janë gjetur donatorë japonezë, me të cilët ka filluar implementimi i “projektit të Xhajkës” dhe është projekt ma i mirë i mundshëm me monitorim të drejtpërdrejtë.

Shala tha se për grandin 8 milionësh nga GTZ-ja gjermane, rreth deponive urbane dhe një milion për asistencë teknike, me çka do të zgjidhet problemi i mbeturinave urbane dhe tani duhet të konfirmohet kompania përkatëse.

Qeveria ka kryer fizibilitetin dhe presim hapa të rëndësishëm në pastrimin e lumenjve me donatorë suedezë, po ashtu, edhe për ujëra të zeza me impiante në zona, ku është urgjente. Ai më tej potencoi edhe mbështetjen që i nevojitet rreth mbetjeve industriale si fushë komplet e pambuluar me legjislacion, Ligjin për Ujëra, i cili duhet të rishikohet dhe premtoi se do të fillojnë me iniciativat konkrete si ministri. Gjithashtu, ai premtoi për z. Adem Salihaj rreth kërkesës së tij për hidrocentrale për prodhim alternativ të energjisë që mos të lejohen pa pasur studim për sasinë e ujit të një lumi.

Adem Salihaj reagoi gjithashtu edhe rreth iniciativave që diskutoi ministri, ngase ministria inicion ndërkaq Kuvendi miraton, duke ndarë buxhet, e jo anasjelltas.

Emilija Rexhepi përkrahu diskutimet rreth mbrojtjes së mjedisit dhe raportin objektiv dhe ftoi për bashkëpunim.

Murat Hoxha u fokusua në planin hapësinor të Kosovës i cili tha ky duhet të përmbushet në shumë segmente, me caktimin e lokacioneve për impiantet e ujërave të zeza, autostrada, shpronësime, prioritete, shpenzime etj., por assesi me raportime por me plane konkrete të punës. Ai potencoi faktin pse MMPH-ja shpronëson nëse atë duhet të bëjë shfrytëzuesi i eksproprijimit apo personi që ka interes.

Ministri reagoi se vetëm e zbatojnë ligjin kurse për autostrada tha se ato caktohen nga Ministria e Infrastrukturës.

Rreth pyetjes së kryetares, për cilësinë e ajrit dhe bashkëpunimin me MSH-në, **Shaip Muja** reagoi duke treguar për ato të dhëna në raport ku evidentohet se ka rritje të sëmundjeve në rajonin e Obiliqit dhe paraqesin shqetësim serioz dhe se bashkëpunimi me MSH-në është obligues e jo a duhet apo nuk duhet.

Adem Salihaj sugjeroi një vizitë studimore për çështje mjedisore dhe kërkoi kontakte të vazhdueshme, në lidhje me këtë propozim me Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit.

Kryetarja ftoi anëtarët e Komisionit për votimin e raportit, i cili u miratua me një abstenim (Time Kadrijaj) dhe u rekomandua që ai të miratohet në mbledhje plenare.

5. Të ndryshme

Për mbledhjen e radhës u definuan institucionet, të cilat do të ftohen të flasin rreth çështjes së iniciuar nga Adem Salihaj, për sëmundjen e fidanëve të mjedrave.

Mbledhja përfundoi në orën 13:05.

E përgatiti:

Stafi mbështetës i Komisionit.

Kryetarja e Komisionit,
Duda Balje